



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve

Nr. 6496 Prot

Tiranë, më 31/12/2024

V E N D I M

Nr. 3, datë 31/12/2024

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË FUNKSIONIMIT TË NJËSISË SË SHËRBIMIT
LIGJOR NË GJYKATËN E LARTË**

Në mbështetje të pikës 9 të nenit 34 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë,

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullave të funksionimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Kjo vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Ilir Panda
Zëvendëskryetar

Enkelejda Metaliaj (Softa)
Anëtare

Albana Boksi
Anëtare

Vojsava Kola
Anëtare

Sokol Sadushi
Kryetar

Margarita Buhali
Anëtare

Arbena Ahmeti
Anëtare

Sandër Simoni
Anëtar




Enton Dhimitri
Anëtar

Ervin Pupe
Anëtar



Medi Bici
Anëtar




Gentian Medja
Anëtar

Sokol Binaj
Anëtar




Artur Kalaja
Anëtar



Sokol Ngresi
Anëtar



Valbon Çekrezi
Anëtar



Asim Vokshi
Anëtar



MIRATOHET

KRYETARI
SOKOL SADUSHI



RREGULLORE

PËR PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË FUNKSIONIMIT TË NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR NË GJYKATËN E LARTË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në pikën 9 të nenit 34 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- "Njësia e Shërbimit Ligjor"** është strukturë pranë Gjykatës së Lartë që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës dhe përbëhet nga ndihmësgjykatë dhe këshilltarë ligjorë jo-magjistratë, të emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve përkatëse ligjore të Gjykatës së Lartë.
- "Këshilltar ligjor"** është nëpunësi civil gjyqësor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë.
- "Ndihmësmagjistrat"** është gjyqtari i komanduar pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor për të ndihmuar gjyqtarët në Gjykatën e Lartë në veprimtarinë vendimmarrëse, në veçanti, kryerjen e kërimit ligjor dhe përgatitjen e opinioneve me shkrim për çështje ligjore materiale ose procedurale.

- c) **“Këshilltar ligjor jomagjistrat”** jurist pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor, i rekrutuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas kriterëve dhe procedurave ligjore përkatëse dhe kryen të njëjtat detyra si ndihmësmagjistrati.
- d) **“Mbledhja e Përgjithshme”** është organi vendimmarrës i përbërë nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të caktuar sipas nenit 136, pika 1 të Kushtetutës.
- dh) **“Kryetari”** është kryetari i Gjykatës së Lartë.

Neni 4 **Statusi i Njesisë së Shërbimit Ligjor**

1. Njësia e Shërbimit Ligjor është strukturë përbërëse administrative pranë Gjykatës së Lartë.
2. Njësia e Shërbimit Ligjorë është në varësi të Kryetarit, i cili drejton dhe mbikqyr administrativisht mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.
3. Nëpunësit e Njesisë së Shërbimit Ligjor i nënshtrohen rregullave të parashikuara për nëpunësit civil gjyqësor, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

KREU II PËRCAKTIMI I NUMRIT TË KËSHILLTARËVE LIGJORE TË NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR

Neni 5 **Numri i këshilltarëve ligjorë**

1. Numri i këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor përcaktohet me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme.
2. Vendimi që përcakton numrin e këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Mbledhja e Përgjithshme mund të rishikojë në mënyrë periodike numrin e këshilltarëve ligjorë për ta përshtatur atë me kërkesat dhe nevojat e Gjykatës.

Neni 6 **Kriteret e përcaktimit të numrit të këshilltarëve ligjorë**

1. Mbledhja e Përgjithshme në përcaktimin e numrit të këshilltarëve ligjorë udhëhiqet nga kriteret objektive, veçanërisht nga numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, raportin ndërmjet numrit të ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë, volumin e punës, burimet financiare në dispozicion, si dhe kërkesat dhe nevojat e brendshme të Gjykatës për një menaxhim të shpejtë dhe efektiv të çështjeve gjyqësore.
2. Numri i ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë duhet të jetë respektivisht jo më pak se dyfishi i numrit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.
3. Kryetari i paraqet Mbledhjes së Përgjithshme një raport me të dhënat e mësipërme dhe e shpërndan para zhvillimit të mbledhjes.

KREU III FUNKSIONIMI I NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR

Neni 7 Parimet etike

1. Këshilltari ligjor kryen detyrën në përputhje me ligjin dhe vepron në çdo kohë në një mënyrë që nxit besimin e publikut në integritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit, duke ruajtur autoritetin dhe imazhin e Gjykatës.
2. Këshilltari ligjor shmang çdo situatë që mund të shkaktojë konflikt interesi apo të ndër marrë veprime ose aktivitete që mund të favorizojnë njërin nga palët apo përfaqësuesit ligjorë të tyre.
3. Këshilltari ligjor nuk lejon që marrëdhëniet e tij familjare, shoqërore ose të tjera të ndikojnë mbi sjelljen ose gjykimin e tij në ushtrimin e detyrës.
4. Këshilltari ligjor shmang bisedat, konsultat, dhënien e opinioneve, komunikimet me palët apo avokatët, çështja e të cilëve është apo mund të jetë në pritje të gjykimit dhe që i është ngarkuar apo mund t'i ngarkohet atij për trajtim.
5. Këshilltari ligjor ruan konfidencialitetin e çdo të dhënë të mësuar për shkak të detyrës së tij dhe nuk bën publike asnjë informacion që lidhet me faktet për të cilat ai merr dijeni gjatë ushtrimit të funksionit, sipas ligjit.
6. Këshilltari ligjor ndalohe të shpërndajë tek të tretët të dhëna apo materiale, në të cilat ai ka akses apo e ka krijuar për shkak të detyrës.

Neni 8 Detyrat e këshilltarit ligjor

1. Këshilltari ligjor, sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator, studion paraprakisht çështjet gjyqësore për të cilat është paraqitur rekurs, ose kërkesa të tjera, përgatit relacionin përkatës dhe jep opinionin e tij ligjor sipas rastit, për pranimin e rekursit, kalimin e çështjes për gjykim apo mospranimin e rekursit.
2. Këshilltari ligjor, duke ndjekur udhëzimet e gjyqtarit të çështjes përgatit relacionin duke paraqitur në mënyrë të saktë, të plotë dhe besnike faktet e çështjes, duke bërë analizën ligjore të problematikave të ngritura në rekurs apo kërkesa të tjera në mënyrë objektive, si dhe, kur i kërkohet nga gjyqtari, duke parashtruar sugjerimin për mënyrën e zgjidhjes së saj, në pajtim me bindjen e tij të brendshme, i lirë nga ndikimet, presionet ose ndërhyrjet e jashtme.
3. Këshilltari ligjor gjatë komunikimit për çështje pune me gjyqtarët ose stafin administrativ të Gjykatës përdor vetëm postën elektronike zyrtare me të cilën është pajisur. Në raste pamundësie absolute dhe ngutshmërie, komunikimi mund të bëhet edhe me mjete të tjera elektronike të pranuarra gjerësisht.
4. Këshilltari ligjor në përgatitjen e materialeve ndihmëse për Gjykatën ndjek rregullat e kërkit ligjor dhe përdor një sistem referencimi të burimit të informacioneve të marra. Në çdo rast, në materialet e përgatitura nga këshilltari të evidentohet qartë pjesa e hartuar me ndihmën e inteligjencës artificiale.

Neni 9

Marrëdhëniet ndërmjet këshilltarit ligjor dhe gjyqtarit

1. Gjyqtari në ushtrimin e detyrës ndihmohet nga këshilltari ligjor i caktuar nga Kryetari për trajtimin çështjes.
2. Këshilltari ligjor, në drejtimin dhe udhëzimet e gjyqtarit relator:
 - a) Studion dhe përgatit çështjen për relativ nga gjyqtari;
 - b) Evidenton, para publikimit të datës së shqyrtimit të çështjeve, shkaqet e dukshme të papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit relator ose të anëtarëve të trupës gjyquese dhe informon menjëherë gjyqtarin relator për mundësinë e heqjes dorë apo zëvendësimit në shqyrtimin e çështjes. Këshilltari ndjek procedurat për zëvendësimin e gjyqtarit që ka dhënë dorëheqjen apo ka papajtueshmëri të dukshme. Këshilltari plotëson ngarkesën për gjyqtarin e hequr dorë apo të zëvendësuar me një çështje tjetër;
 - c) Mbikëqyr procedurën e njoftimit ndaj palëve nga sekretaria gjyqësore, sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator,
 - ç) nxjerr dhe rekomandon zgjidhje për çështjet ligjore që ngrihen gjatë studimit të dosjes gjyqësore,
 - d) paraqet opinionin e tij ligjor për zgjidhjen e çështjes, kur i kërkohet nga gjyqtari.

Neni 10

Përmbajtja e materialit për relativ

1. Materiali i hartuar nga këshilltari ligjor me qëllim relativimin e çështjes nga gjyqtari përmban:
 - a) numrin e çështjes, datën e regjistrimit, palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre;
 - b) objektin e padisë, kundërpadisë apo ndërhyrjes kryesore ose akuzën penale;
 - c) bazën ligjore të padisë/kundërpadisë/ndërhyrjes kryesore ose të akuzës penale;
 - ç) një përmbledhje të shkurtër të fakteve dhe natyrës juridike të konfliktit;
 - d) shkaqet e rekursit dhe përmbajtjen e përmbledhur të kundërrekursit;
 - dh) dispozitivët në rend kronologjik të vendimeve përkatëse të gjykatave që kanë gjykuar më parë çështjen së bashku me emrat e gjyqtarëve që kanë qenë pjesë e trupave gjyquese që kanë dhënë këto vendime;
 - e) pala që ka ushtruar të drejtën e ankimit në shkallën e dytë dhe shkaqet përkatëse të ankimit;
 - ë) analizën e praktikës gjyqësore apo materiale të tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes (vendime gjyqësore analoge, vendime të Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencë të gjykatave të huaja apo të GJEDNJ) si dhe opinionin e tij juridik për mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore kur i kërkohet nga gjyqtari, etj.
2. Material i përmbahet me përpikmëri formateve të miratuara nga organet drejtuese të Gjykatës dhe i paraqitet gjyqtarit relator të paktën 5 ditë pune para datës së caktuar për gjykimin e çështjes.

3. Këshilltari ligjor merr pjesë në gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi kur prania e tij vlerësohet si e domosdoshme nga trupa gjykuese.
4. Këshilltari ligjor, pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes, bazuar në udhëzimet e gjyqtarit relator, harton projektvendimin e kolegjit brenda afateve ligjore.

Neni 11

Numri i çështjeve për trajtim

1. Çdo këshilltar ligjor trajton si rregull jo më pak se 25 (njëzetepesë) çështje në muaj.
2. Çdo Kolegj cakton numrin e çështjeve për trajtim sipas natyrës dhe kategorisë së çështjes.
3. Kur kërkohet nga Kryetari i Gjykatës, këshilltarët ligjorë përgatisin raporte periodike për punën e kryer.

Neni 12

Dorëzimi i relacionit të çështjes

1. Këshilltari ligjor i dorëzon elektronikisht ose të printuar materialin për relativ gjyqtarit relator, të paktën 5 ditë pune para datës së caktuar për shqyrtimin e çështjes.
2. Në rastin kur gjyqtari relator e konsideron të pranueshëm materialin për relativ të konceptuar nga këshilltari ligjor bën shënimin "u mor dijeni" dhe e firmos atë. Relacioni i çështjes i firmosur nga gjyqtari dhe këshilltari ligjor përshihet në dosjen gjyqësore.
3. Në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore relacioni pasqyrohet në rubrikën e caktuar që përmban materialet përgatitore të çështjes.

Neni 13

Kryerja e detyrave të tjera

Këshilltari ligjor, me urdhër të Kryetarit, kolegjit apo gjyqtarit relator, mund të kryejë dhe detyra të tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Gjykatës.

Neni 14

Organizimi i mbledhjeve periodike

Kryetari organizon mbledhje periodike me këshilltarët ligjorë, edhe me praninë e gjyqtarëve kur e gjykon të arsyeshme, për çështje të ndryshme që lidhen me funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës.

Neni 15

Përgjegjësia disiplinore

Këshilltari ligjor ka përgjegjësi disiplinore sipas dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore që parashikojnë përgjegjësinë disiplinore të magistratëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas rastit.

KREU IV
NDARJA E KËSHILLTARËVE LIGJORË DHE ÇAKTIMI I ÇËSHTJEVE

Neni 16

Ndarja e këshilltarëve ligjorë në kolegje

1. Kryetari bën ndarjen dhe lëvizjen e këshilltarëve ligjorë në kolegje bazuar në përvojën dhe profilizimin personal, ngarkesën e punës së çdo kolegj, duke u kujdesur që të sigurohet vazhdimësia e jurisprudencës së kolegjeve dhe ruajtja e përvojës profesionale të këshilltarit ligjor.
2. Kryetari, në raste të veçanta, për të përballuar ngarkesën e punës së një kolegj, mund të ngarkojë edhe këshilltarë ligjorë të kolegjeve të tjera.
3. Ndarja e këshilltarëve ligjor në secilin kolegj bëhet e tillë që shpërndarja e ndihmësmagjistratëve të komanduar të jetë sa më e barabartë.

Neni 17

Përgatitja e listës së çështjeve

1. Kryesekretari i Gjykatës, çdo të hënë, dhe kur kjo është pushim, ditën pasardhëse, përgatit listën e çështjeve të regjistruara në sistemin e menaxhimit elektronik të çështjeve dhe ia paraqet Kryetarit për të caktuar këshilltarin ligjor që do të përgatisë çështjen për relativim.
2. Format i listës së caktimit të çështjeve për këshilltarin ligjor është sipas Aneksit 1 të kësaj rregullore.

Neni 18

Caktimi i këshilltarit ligjor për trajtimin e çështjes gjyqësore

1. Kryetari, pas marrjes së listës së çështjeve, cakton një këshilltar ligjor për çdo çështje, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tij, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet këshilltarëve ligjore.
2. Këshilltarët ligjorë ndalohen të këmbëjnë mes tyre çështjet gjyqësore si dhe t'i nxjerrin ato jashtë mjediseve të Gjykatës.
3. Kryetari, për çështje urgjente, cakton këshilltarin ligjor menjëherë pas caktimit me short të gjyqtarit relator.

Neni 19

Tërheqja e dosjeve gjyqësore

1. Tërheqja e dosjeve nga këshilltarët ligjorë bëhet kundrejt paraqitjes në sekretari të kërkesës sipas miratimit paraprak me e-mail nga gjyqtari relator, e cila duhet të përmbajë listën e çështjeve për t'u tërhequr.
2. Dorëzimi i tyre te këshilltari ligjor bëhet kundrejt nënshkrimit të tij në regjistrin përkatës.

Neni 20

Kalimi i çështjeve të patrajuara të këshilltarit ligjor

1. Kur një këshilltar ligjor përfundon marrëdhëniet e punës me Gjykatën e Lartë, çështjet e patrajuara që kishte në ngarkim, i kalojnë automatikisht për trajtim këshilltarit të ri që zë vendin e tij.
2. Në rast se plotësimi i vendit vakant të këshilltarit ligjor zgjatet përtej një kohe të arsyeshme, ose ka urgjenca në trajtimin e çështjeve, Kryetari ricakton një apo disa këshilltarë të tjerë ligjore për trajtimin e çështjeve në ngarkim të këshilltarit ligjor të larguar.
3. Rregulli i parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni zbatohet dhe në rastin e pezullimit të këshilltarit ligjor nga detyra apo marrjes leje për një kohë relativisht të gjatë.

KREU V

PROCEDURA PËR HEQJEN DORË NGA TRAJTIMI I ÇËSHTJES

Neni 21

Shkaqet e heqjes dorë të këshilltarit ligjor

1. Shkaqet për heqjen dorë të këshilltarit ligjor janë të njëjta me ato që zbatohen edhe për magjistratët. Këshilltari ligjor, sapo konstaton shkakun e papajtueshmërisë, njofton gjyqtarin relator dhe Kryetarin.
2. Nuk përbën shkak për heqjen dorë nga çështja rasti kur këshilltari ligjor nuk ndan të njëjtin opinion ligjor me gjyqtarin relator për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Neni 22

Kërkesa për heqjen dorë nga trajtimi i çështjes

Këshilltari ligjor, kur beson se ka shkaqe ligjore që e pengojnë të trajtojë një çështje gjyqësore, paraqet kërkesë për heqje dorë te Kryetari. Në kërkesë këshilltari ligjor duhet të paraqesë shkakun ligjor që përbën pengesë për trajtimin e çështjes nga ana e tij dhe datën kur ka marrë dijeni për këtë shkak.

Neni 23

Shqyrtimi i kërkesës dhe vendimmarrja

1. Kryetari, pas shqyrtimit të kërkesës, merr vendim për pranimin apo refuzimin e saj. Në rast të pranimit të kërkesës për heqje dorë, Kryetari cakton një këshilltar tjetër ligjor për trajtimin e çështjes.
2. Kërkesa për heqje dorë e këshilltarit ligjor edhe vendimi përkatës i Kryetarit regjistrohen në një regjistër të veçantë, i cili mbahet në protokollin e Gjykatës.

KREU VI
PROCEDURAT PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË NJËSINË E SHËRBIMIT
LIGJOR

Neni 24

Kërkesa për plotësimin e vendit të lirë në Njësinë e Shërbimit Ligjor

Kryetari, jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi i periudhës së komandimit të ndihmësmagjistratit, dhe 1 muaj nga ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të këshilltarit ligjor jo-magjistrat, i paraqet kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor për plotësimin e vendit të lirë në Njësinë e Shërbimit Ligjor.

Neni 25

Vlerësimi i kandidatëve nga radhët e magjistratëve të propozuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

Brenda 10 ditëve nga dërgimi i listës me kandidatë magjistratë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kryetari vlerëson aplikimet, bën përzgjedhjen e magjistratëve dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e tyre si ndihmësmagjistrat në Njësinë e Shërbimit Ligjor.

Neni 26

Kriteret e përzgjedhjes së magjistratit të komanduar

Kryetari, në përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e ndihmësmagjistratit, merr në konsideratë mendimin e gjyqtarëve të Gjykatës, përvojën profesionale të magjistratit, fushën e specializimit apo profilizimit të tij, si dhe nevojat e secilit koleg për ndihmësmagjistratë.

Neni 27

Komandimi i ndihmësmagjistratit për një mandat tjetër

1. Këshilltari ligjor ndihmësmagjistrat, jo më vonë se 3 muaj nga dita e mbarimit të afatit të mandatit të parë, nëse dëshiron të vazhdojë komandimin në Gjykatën e Lartë, i paraqet kërkesë me shkrim Kryetarit për vazhdimin e komandimit edhe për një mandat tjetër.
2. Kryetari, bazuar në vlerësimet e punës së ndihmësmagjistratit, mund t'i paraqesë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesë për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën e Lartë edhe për një mandat tjetër.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 28

Caktimi i çështjeve për trajtim

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, caktimi i këshilltarëve ligjorë për trajtimin e çështjeve gjyqësore bëhet sipas dispozitave të saj. Çështjet gjyqësore për të cilat janë caktuar

këshilltarët ligjorë para hyrjes në fuqi të rregullores, përgatiten nga këta këshilltarë ligjorë, përveç rasteve kur është e nevojshme zëvendësimi, i cili kryhet sipas dispozitave të rregullores.

Neni 29

Fuqia juridike e akteve të miratuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore

Të gjitha aktet e miratuara nga Kryetari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, të cilat trajtojnë çështje që lidhen me veprimtarinë e Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe që nuk bien ndesh me dispozitat e saj, kanë fuqi të plotë juridike dhe janë të zbatueshme nga këshilltarët ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Neni 30

Hyrja në fuqi

1. Rregullorja konsiderohet e miratuar kur votohet me shumicë të cilësuar prej 2/3 të anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme.
2. Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj prej Mbledhjes së Përgjithshme dhe botohet në faqen në internet të Gjykatës së Lartë.

Neni 31

Ndryshimet e rregullores

1. Propozimet për ndryshimet në rregullore mund të bëhen nga Kryetari, ose me kërkesën e jo më pak se 1/5 së anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme.
2. Ndryshimet në këtë rregullore janë të vlefshme dhe hyjnë në fuqi kur ato votohen me shumicë të cilësuar prej 2/3 të Mbledhjes së Përgjithshme.

Miratuar, në datë 25.11.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

Tiranë, më ___ / ___ /202__

Lista e caktimit të çështjeve për këshilltarin ligjor

Nr.	Çështja (Palët dhe objekti)	Gjyqtari relator	Këshilltari ligjor
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			
21.			
22.			
23.			
24.			
25.			
26.			
27.			
28.			
29.			
30.			
31.			
32.			
33.			